



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT PËR PERSONA TE RIATDHESUAR

Thirrje për Aplikim

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), shpallin thirrjen e hapur për personat e riatdhesuar për vitin 2018 për dorëzimin e aplikacioneve për hapjen e bizneseve me mbështetje me paisje teknike në kuadër të Programit të Vetëpunësimit.

Rreth Programit të Vetëpunësimit

Qëllimi i Programit të Vetëpunësimit është të mbështesë personat e riatdhesuar në krijimin e planeve të realizueshme të biznesit që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurrues duke promovuar vetëpunësimin si masë aktive të tregut të punës. Mbështetja me grante do të ofrojë paisje teknike për realizimin e Planit të Biznesit. Programi në vazhdimësi do të asistojë në zhvillimin e biznesit përmes këshillimit për t'i ndihmuar personat e riatdhesuar të papunë me kualifikime të orientuar për të qenë të suksesshëm në fushën e zgjedhur. Programi i prezentuar i vetëpunësimit është program konkurrues për të garantuar kthimin më të lartë të mundshëm të investimit. Procesi i përzgjedhjes ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë dhe t'i mbështesë idetë dhe planet më të mira të biznesit që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Mbështetja nga programi

Qëllimi i Programit është që të sigurojë mbështetje hap-pas-hapi për planet e biznesit që kanë mundësinë më të madhe të arrijnë sukses dhe të përballen me barrierat e ndryshme të tregut. Për këto qëllime Programi është ndarë në dy faza:

Faza e parë: Pjesëmarrësit e kualifikuar fillimisht aplikojnë me Planin e tyre të biznesit përmes formularit të aplikimit, të cilin e dorëzojnë në Zyren e Punësimit. Komisioni i verifikimit Administrativ vendosë nëse Plani i Biznesit të secilit aplikant plotëson kriteret për të kaluar në fazën e dytë, në vlerësimin e ekspertëve.

Faza e dytë: Aplikantët që kalojnë me sukses fazën e verifikimit administrativ, kalojnë në fazën e vlerësimit teknik nga ana e ekspertëve si dhe nëse ekspertët zgjedhin planin përkatës, aplikantët ftohen në intervistë për t'u verifikuar planin përkatës i biznesit dhe në fund pas

konfirmimit të të gjitha informatave merret vendimi final nga komisioni.

Sektorët ekonomik me prioritet dhe të pranueshëm

Aktivitetet e biznesit që do mbështeten, duhet të jenë në njërin nga gjashtë sektorët e mëposhtëm ekonomik, sektorë të përzgjedhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), që kanë potencial më të lartë për rritje ekonomike në Kosovë përkatësisht:

- Përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit, me fokus në përpunimin e mishit;
- TIK;
- Ndërtimtaria;
- Industria e përpunimit të metalit;
- Industria e tekstilit;
- Industria e përpunimit të drurit.

Në kuadër të sektorëve të specifikuar më lartë, do të përfshihen edhe disa nga zanatet dhe shërbimet specifike si: Floktare, Auto-Mekanik, Auto-Ngjyrosje, Gomister.

Luteni të shihni shtojcën Nr. 1 të kësaj thirrjeje ku janë të specifikuara profesionet që do të mbështeten me mjete dhe paisje në kuadër të Programit të Vetëpunësimit.

Idetë e biznesit **të pa pranueshme** për të marrë pjesë në Program janë:

- të gjitha llojet e veprimtarive në kuadër të sektorit primar të bujqësisë ose blegtorisë;
- Të gjitha llojet e veprimtarive të cilat nuk janë të shtojcën Nr. 1 të kësaj thirrjeje;
- veprimtaritë me patundshmëri, lizing;
- veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin;
- prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit dhe rakisë;
- prodhimi i produkteve të duhanit;
- prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- prodhimi që përdor teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, ujit, tokës etj.);
- bizneset joformale;
- aktivitete biznesore nga sektori i tregëtisë.

Aplikantët e pranueshëm

Të gjithë aplikantët e interesuar për tu kualifikuar për aplikim, duhet të jenë persona të riatdhesuar sipas rregullores Nr. 13/2017 për Riintegrimin e Personave të riatdhesuar. Ata janë të obliguar që personalisht të marrin pjesë në fazat e Programit dhe të jenë drejtpërsëdrejti të përfshirë në zhvillimin dhe realizimin e biznesit. Kandidatët e kualifikuar dhe pjesëmarrës në Program **duhet të jenë persona të riatdhesuar të regjistruar si të papunë në Zyrat e Punësimit (ZP) si dhe duhet të kenë të kryer trajnimin “Fillo Biznesin Tuaj” në Qendrën e Aftësisë Profesionale**, kryerja e ndonjë trajnim tjetër të akredituar si dëshmi se e njohin profesionin përkatës në kohën e aplikimit do të jetë përparësi. Pas çdo thirrjeje, programi do qendrojë i hapur së paku 30 ditë. Punëkërkuessit që nuk e kanë përfunduar trajnimin “Fillo Biznesin Tuaj” në QAP, gjatë kësaj periudhe kanë mundësi t'i drejtohen QAP përkatës dhe ta përfundojnë trajnimin. Punëkërkuessit që nuk kanë mundësi, mund të presin për ndonjë thirrje

tjetër për aplikim në kuadër të Programit. Këshilltarët për punësim do të sigurojnë sesione këshillimi gjatë të cilëve punëkërkuarët informohen nëse i plotësojnë kushtet të aplikojnë në këtë Program.

Personave të papunë të grupeve në vijim do t'u jepet prioritet:

- të papunët afatgjatë (më shumë se 12 muaj);
- të rinjtë (18-29 vjeç);
- gratë;
- të mbijetuarit e dhunës në baza gjinore;
- përfitues të ndihmës sociale;
- personat e vetëm, me një ose më shumë anëtarë që varen nga ai/a (prindër vetëushqyes);
- personat nga viset rurale;
- personat me aftësi të kufizuara;
- grupet e pakicave etnike.

Personat që nuk kualifikohen për aplikim janë ata persona të cilët:

- nuk janë të regjistruar në ZP;
- nuk kanë përfunduar trajnimin në QAP;
- nuk janë persona të riatdhesuar;
- kanë përfituar më heret plan biznesi ose masa tjera aktive të punësimit;
- janë në konflikt të interesit me palë të përfshira dhe vendimmarrëse në Program;
- janë punëkërkuar që kanë përfituar nga masa të tjera aktive të tregut të punës gjatë 12 muajve të mëparshëm kalendarik (nga data e aplikimit për Ide të Biznesit).
- Personat që kanë biznes të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës;
- Te Riatdhesuarit ose familjaret e të cilëve kanë përfituar plan biznesi siq është e definuar me rregullore.

Mbështetja nga Programi

Programi i vetëpunësimit do të sigurojë mjete dhe paisje teknike në vlerë **deri 3,000 Euro për çdo plan të biznesit të zhvilluar me sukses** që është miratuar në kuadër të procesit të përzgjedhjes ku do të ofrohet mbështetje sipas planit të biznesit.

Aplikantët që sigurojnë kontribut financiar ekuivalent me së paku 20% të financimit të kërkuar nga granti, do të marrin pikë shtesë (3 pikë prej 100 në total) nga vlerësimi i planeve të biznesit. Nëse kontributi është më i vogël se 20 %, nuk do të jepen pikë shtesë.

Aplikantët e miratuar mund të planifikojnë për financim shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, lizing, grante, etj.) në dispozicion në Kosovë përmes institucioneve financiare ose programeve të financuara nga donatorët. Instrumentet e tilla rekomandohen për zgjerim të mëtejshëm të biznesit që nuk është mbuluar nga plani i biznesit, me mbështetje përmes grantit të këtij Programi.

Përparësi do t'u jepet aplikantëve me ide unike të biznesit (të papërsëritura te aplikantët tjerë) ose që ofrojnë produkte/shërbime të reja, përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji të reja

prodhimi dhe/ose që kursejnë energji elektrike, përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë, si dhe biznese që krijojnë më shumë se 3 vende pune (vetëm për të papunët e regjistruar).

Kriteret e vlerësimit të Biznes Planeve

Çdo plan i biznesit vlerësohet në dy faza :

1. Verifikimi Administrativ

Verifikimi administrativ konsiston në **verifikimin e plotësisë dhe vërtetësisë së dokumenteve të kërkuara nga Programi. Disa nga elementet që verifikohen janë:**

- Modeli i planit të biznesit dhe bashkëlidhjet;
- Posedimi i certifikatës së trajnimit;
- Posedimi i referencave nga punëdhënësit paraprak;
- Posedimi i certifikatave për njohjen e profesionit, diplomave etj.

2. Vlerësimi i ekspertëve

Vlerësimi bëhet nga dy ekspertë të pavarur. Secili ekspert vlerëson planin e biznesit dhe nuk diskuton vlerësimet e tij/saj me të tjerët. Nëse ndryshimi ndërmjet rezultateve të dy ekspertëve është më i madh se 15 pikë, plani i biznesit i jepet një tjetër eksperti për një vlerësim të tretë. Rezultati përfundimtar për këtë plan të biznesit është rezultati mesatar i dy vlerësimeve. Ekspertët e vlerësimit bëjnë vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në bazë të 2 (dy) kriterëve të përshkruara sipas Formularit të vlerësimit të planit të biznesit.

Rezultati maksimal është 100 pikë, dhe matet sipas kriterëve të mëposhtme:

- Realizueshmëria financiare e biznesit;
- Resurset në dispozicion për biznesin – objekti, paisjet, furnizimet dhe stafi;
- Njohja e llojit përkatës të biznesit, organizimi i biznesit dhe menaxhimi i rrezikut;
- Vlerësimi i tregut, njohja e konkurrencës dhe marketingu.

Si të aplikoni

Të gjithë personat e interesuar që plotësojnë kushtet për aplikim, të kompletojnë **Formularin e aplikimit për plan të biznesit** dhe ta dorëzojnë atë në Zyrën e Punësimit ku ai/ajo është i/e regjistruar, **në një original dhe dy kopje tjera identike**, në shqip apo serbisht në zarf të mbyllur. Në rast se zarfi nuk është i mbyllur nuk do të merret parasysh. Aplikantët janë të obliguar të sigurojnë si bashkëlidhje në *Formularin e Aplikimit CV-në e tyre (nga APRK)* dhe të gjitha dokumentet që dëshmojnë shkollimin, certifikaten e trajnimit në Qendrën e Aftësimit profesional, dëshmi mbi kualifikimin dhe përvojën e tyre që përputhet me idenë e paraqitur të biznesit si dhe dokumentet tjera përcjellese të cilat përshkruhen në Planin e Biznesit (Pjesa e Udhëzimeve).

Aplikimi për plan të biznesit duhet të dorëzohet **në zyrën më të afërt të punësimit ku aplikuesi/ja është regjistruar si i/e papunë**. Formulari i plotësuar i Aplikimit me dokumentet e bashkëlidhura duhet të dorëzohet personalisht në zyrën përkatëse të punësimit brenda afatit të caktuar në shpallje.

Çdo aplikacion i dërguar i pa plotësuar me dokumentacion përkatës dhe pas afatit të fundit të shpallur, konsiderohet i pavlefshëm.

Data e fundit e dorëzimit të aplikimeve është 13 Gusht 2018, në orën 14:00.

Secili aplikant mund të aplikojë me vetëm një plan të biznesit (një anëtar për familje).

Informata tjera

Informata shtesë dhe Formulari i Aplikimit mund të gjenden në:

www.mpms.rks-gov.net dhe <http://apr.k.rks-gov.net/>

dhe në secilën Zyrë të Punësimit në Kosovë.

Në rast se keni pyetje shtesë për programin e vetëpunësimit, ju lutem kontaktoni Zyrën e UNDP përmes postës elektronike: almp.ks@undp.org.

SHTOJCË: PROFESIONET E PRANUARA PËR TË CILAT OFROHEN MJETE DHE PAISJE SIPAS SEKTORËVE

- Përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit:
 - Përgaditja e ëmbëlsirave, përpunimi dhe paketimi ushqimeve të ndryshme,
 - Përpunimi i mishit.
- TIK krahas me kontraktimin e jashtëm të proceseve të biznesit dhe sektori i qendrave të mbështetjes për konsumatorë:

- Zhvillimi i Programeve,
- Servisimi i paisjve në kuadër të TIK,
- Rrjetizim dhe ofrim i shërbimeve të TIK.
- Ndërtimtaria:
 - Instalues i ngrohjes qendrore,
 - Suvatues dhe Fasadues,
 - Instalues i sanitarisë,
 - Instalues elektrikë,
 - Murator.
- Industria e përpunimit të metalit:
 - Saldues,
 - Metalpunues.
- Industria e tekstilit:
 - Rrobaqepësi,
 - Qëndisje.
- Industria e përpunimit të drurit:
 - Zdrukthëtari,
 - Mobileri.
- Tjera:

Në kuadër të sektorëve të specifikuar më lartë, do të përfshihen edhe disa nga zanatet dhe shërbimet specifike si: Floktare, Auto-Mekanik, Auto-Ngjyrosje, Gomister.